

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“Blerje Kancelari”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**22852000-7; 30125120-8; 30192000-1; 30192124-6; 30192125-3; 30192130-1; 30192700-8; 30192800-9; 30197220-4.**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**- Fondi total 1 431 213.18 (një milion e katërqind e tridhjetë e një mijë e dyqind e trembëdhjetë pikë tetëmbëdhjetë) lekë pa T.V.SH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për 2 vitet e fundit financiare 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ato i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të Operatorëve Ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

2.2.2. Kopje të çertifikuara të bilanceve vjetore të paraqitura për vitet financiare 2021, 2022 ku bilancet e kërkuar nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

### **Aftësitë teknike dhe profesionale:**

- 2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.
- Operatori ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasi dhe llojin e mallrave të furnizuara.
  - Operatori Ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, sasi dhe llojin e mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo

më pak se 20 % të vlerës së perlllogaritur te kontrates, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

2.3.2. Të jetë i pajisur me çertifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente, të vlefshme, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila përfshin objektin e prokurimit.

**Argumentimi:** *Kriteri që OE duhet të jetë i pajisur me çertifikatë ISO 9001:2015 konsiston në kërkesën që OE konkurues duhet të zotërojë “Sistemin e menaxhimit të cilësisë” së produkteve që ai tregëton.*

2.3.3 Në rastin që Operatori ekonomik do të paraqesë bojëra (tonera) origjinale, GENUINE duhet të paraqesë një vetëdeklarim ku deklaron se në momentin e dorëzimit konfeksionet e bojërave (tonerave), janë të reja dhe të padëmtuara, nuk janë të rimbushura dhe plotësojnë të gjithë elementet e sigurisë.

Në rastin që OE do të paraqesë Tонера ekuivalente, përveç deklaratës së mësipërme se konfeksionet janë të reja e të padëmtuara, duhet të deklarojë, se merr përsipër përgjegjësinë që tonerat e paraqitur do të njihen elektronikisht nga pajisjet respektive të AK.

OE do të marrë përsipër me anën e kësaj deklarate, përgjegjësinë për tonerat e lëvruar nga moment i lëvrimin, deri në momentin e instalimit të tonerave në pajisjet respektive, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

**Argumentimi:** *Kriteri që Operatori ekonomik deklaron se në momentin e dorëzimit konfeksionet e bojërave (tonerave), janë të reja dhe të padëmtuara, nuk janë të rimbushura dhe plotësojnë të gjithë elementet e sigurisë, është vendosur për të minimizuar mundësinë e ofrimit të produkteve të falsifikuara, të rimbushura, apo të dëmtuara pasi përdorimi i këtyre të fundit në pajisjet printer/fotokopje i dëmton ato dhe në pjesën më të madhe të paisjeve nuk njihet elektronikisht prej tyre. Kërkesa e AK që “në rastin që OE do të paraqesë Tонера ekuivalente, përveç deklaratës se konfeksionet janë të reja e të padëmtuara, duhet të deklarojë, se merr përsipër përgjegjësinë që tonerat e paraqitur do të njihen elektronikisht nga pajisjet respektive të AK”, duke qenë se pajisjet elektronike (printerat) në raport me tonerat, funksionojnë me “cheap”, ky kriter është vendosur për të zgjidhur problemet që vijnë si pasojë e “mos njohjes” elektrinikisht të tonerave nga ana e paisjeve respektive (printerave). Përsa i përket kërkesës së AK që “OE do të marrë përsipër përgjegjësinë për tonerat e lëvruar nga moment i lëvrimin, deri në momentin e instalimit të tonerave në pajisjet respektive” është vendosur me qëllim që OE të jetë përgjegjës për të zgjidhur problematikat që lindin në momentin e montimit të tonerave në paisjet respektive gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.*

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 8 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon 1 (një) automjet qe do te sherbeje per transportin e produkteve objekt prokurimi, ne pronësi ose ne perdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin që disponon 1 (një) automjet, ne pronësi ose ne perdorim sipas kontrates noteriale, te vertetuar me:

- leje qarkullimi,
- çertifikate pronësie
- siguracion (TPL)
- çertifikatë e kontrollit teknik

Në rastin kur automjeti është me qera/në përdorim, të paraqesë kontratën noteriale përkatëse si dhe dokumentat e kërkuara të automjetit.

**Argumentimi:** *Kriteri që OE ku të deklarojë se disponon 1(një) automjet që do të shërbejë për transportin e produkteve objekt prokurimi, është vendosur në funksion të zbatimit të kontratës për procesin e lëvrimit të mallit në magazinën e AK, sipas grafikut të lëvrimit.*

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqes një vetëdeklarim ku të deklarojë se në momentin e dorëzimit te mallit (Tонера) tek autoritetet kontraktore , malli do të shoqërohet me:

- **Fletë garanci** për produktet e paraqitura, ku të jenë përcaktuar detyrimet e OE dhe përgjegjësia e tij për tonerat e lëvruar që nga momenti i lëvrimit e deri në momentin kur boja vendoset ne printerin/fotokopjen për të cilën ajo është kërkuar.
- **Certifikatën e origjinës.**

**Argumentimi:** *Kërkesa që tonerat duhet të shoqërohen me Fletë garanci është vëndosur për faktin që tonerat do të montohen në paisjet respektive në varësi të konsumit në kohë të ndryshme. Për këtë OE duhet të garantojë që ato do të jenë në pëputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga AK jo vetëm në momentin e lëvrimit por edhe në momentin e montimit në paisjen respektive.*

- *Kërkesa që malli do të shoqërohet me çertifikatë origjine është vendosur në funksion të kërkesës që tonerat duhet të jenë origjinale dhe sipas standardeve të CE.*

2.3.6 Ditën e hapjes së tenderit, Operatorët ekonomikë konkurrues duhet te paraqesin një mostër sipas specifikimeve teknike te Autoritetit Kontraktor per artikujt e mëposhtëm:

Nr.	Emërtimi i artikullit	Njësia	Sasia
-----	-----------------------	--------	-------

\_\_\_\_\_ Adresa: Rruga “Barrikadave”, KodiPostar 1001, tel.:+355 4222991, ëeb: femijetetiranes.al, email:femijet@tirana.al\_\_\_\_\_

1	Dosje me llastik	Copë	1
2	Dosje Arkive me Lidhese	Copë	1
3	Dosje me mekanizem	Copë	1
4	Leter A4	Pako	1
5	Leter A3	Pako	1
6	Qese dokumentash	Pako	1
7	Makine kapse nr. 24/6	Copë	1
8	Makine kapse nr. 10	Copë	1
9	Makina llogaritese	Copë	1
10	Stilolapsa blu	Copë	1
11	Blllok flete- hyrje	Copë	1
12	Blllok flete- dalje	Copë	1
13	Boje per Printer/ skaner/ fotokopje Xerox Copier eorcenter 5335	Copë	1
14	Boje per Printer/ skaner/ fotokopje Xerox Copier Versalink B 7030	Copë	1
15	Bojë për Printer/ skaner/ fotokopje Lexmark MX310 dn	Copë	1
16	Bojë për Printer/ skaner/ fotokopje Lexmark MX317 dn	Copë	1

Mostrat do paraqitet ne daten dhe oren e hapjes se ofertave, prane D.P.Ç.K me adrese “Rr. E Barrikadave, Çerdhja nr. 1 Tirane”.

Mostrat e kërkuaa duhet të kenë një etiketë me vulë e cila të përmbaje përshkrimin:

- *Moster “emri i artikullit”,*
- *Daten e zhvillimit te tenderit,*
- *Emrin e ofertuesit,*
- *Nënshkrimin dhe Vulen e operatorit ekonomik*

Për artikullin mostër bojrat (tonerat) OE duhet të kenë në vemendje që:

1- Bojrat (tonerat) duhet të jenë te mbështjella në qese në mënyrë hermetike;

2- Në ambalazhin e tyre duhet të jetë përcaktuar:

- Emërtimi i produktit
- Emërtimi i printerit për të cilin është prodhuar boja (toneri)
- Pulla e sigurisë nga prodhuesi (*e vendosur në pozicionin e duhur për mos-lejimin e hapjes së kutisë ambalazhit*).
- Të jenë të çertifikuara sipas standardeve të CE.

**Mungesa e mostrës është kusht skualifikues.**

**Argumentim:** AK ka kërkuar që ditën e hapjes së tenderit, OE konkurues duhet te paraqesin një mostër sipas specifikimeve teknike, për disa nga artikujt e listës objekt prokurimi. Artikujt për të

*cilët kërkohet mostër janë përzgjedhur në raport me karakteristikat specifike që ato kanë si dhe në raport me sasinë dhe vlerën që ato zënë në listën e përgjithshme të artikujve objekt prokurimi.*

## **II. Argumentim për hartimin e specifikimeve teknike:**

*Për hartimin e specifikimeve teknike komisioni ju është referuar kërkesave të institucionit për llojin, tipin, përmasat dhe të dhënat teknike specifike të secilit artikull që kërkohet.*

*Karakteristikat dhe përmasat e artikujve janë vendosur në përshtatje me natyrën dhe nevojat specifike të pozicioneve të punës për secilin nga sektorët e DPCK në funksion të kryerjes së detyrave funksionale të tyre. Përsa I përket specifikimeve teknike të tonerave, ato janë vendosur në raport me llojet e paisjeve elektronike printera/fotokopje për të cilat ato do të përdoren. Cilësimet për “Part Number”, ose ekuivalente janë të lidhura ngushtë me natyrën e funksionimit të tonerave në paisjet në të cilat ato do të montohen dhe që duhet të “njihen” elektronikisht prej tyre.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*